



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
VU644-22-5562-1-3-6/C477
14 Nr. 374/22
Dt. 01.07.2022

KONTRATË FURNIZIMI

Palët kontraktuese :

1. Komuna e Vushtrisë, si Autoritet Kontraktues, të cilën e përfaqëson: **Hyda Dallku – Drejtor i Drejtorisë për Prokurim Publik** (në tekstin e mëtejme **PORORSITËSI**) , dhe
2. “ **AWA** “ **emri i biznesit**, me seli në **Prishtinë**, me **ARBK : 811345976**, të cilën e përfaqëson **z. Arjanit Rexhepi**, në tekstin e mëtejme: **FURNIZUESI** ,

, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizimet e shënuara me poshtë: **Furnizimi – blerja e aparatit fotografik profesional për zyrën e kryetarit** , me numër identifikues:

Nr. i prokurimit	VU644	2	2	55	6	2	1	3	6
Nr. iibrendshëm	VU644	2	2	0	4	6	1	3	6

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë : **Furnizimi me aparat fotografik profesiona për nevoja të zyrës së kryetarit të komunës, në pajtim me Specifikat Teknike pjesë përbërëse e kësaj Kontrate.**

1.2 Kontrata hynë në fuqi me datën e nënshkrimit dhe përfundon brenda afatit: **jo më gjatë se 15 ditë kalendarike pas datës së nënshkrimit të kontratës.**

1.3 Vendi i dërgimit do të jetë : **depoja kryesore e Administratës komunale në objektin e Komunës në Vushtrri, në pajtim me Aneksin 1. Specifikimet Teknike të Detyrueshme, pjesë përbërëse e Dosjes së Tenderit dhe e kësaj Kontrate.**

1.4 Incotermi i aplikueshëm do të jetë **DDP¹** (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **3.180,00€ (tremijnjëqindetdhjetë/00 Euro).**

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës pasi që **Menaxheri i Kontratës i Autoritetit Kontraktues të konfirmoi me shkrim praninë dhe dorëzimin e pajisjes (aparatit fotografik profesional) respektivisht pas dorëzimit të Raportit me shkrim se pajisja është dorëzuar – pranuar nga personat kompetent në institucionin në fjalë, si në aspektin sasior ashtu dhe në aspektin cilësor. Raporti me shkrim i hartuar dhe nënshkruar nga Menaxheri i Kontratës do të dorëzohet, një kopje Kontraktuesit dhe një kopje Drejtorisë për Prokurim me qëllim të procedimit me pagesat për furnizimet dhe / ose shërbimet e përfunduara.**

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i **furnizimeve dhe / ose shërbimeve** është përgjegjësi e Furnizuesit ndërsa pajisa e dorëzuar duhet, në të gjitha aspektet, të plotësojë specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni për cilësinë e mallit do të mbetet përgjegjësi e furnizuesit. **Kontraktuesdi duhet të dorëzojë deklaratë me shkrim të nënshkruar dhe të vëltur për garancionin e kualitetit në tërë vlerën e kontratës për periudhën e kohëzgjatëjes prej 12muaj nga data e dorëzimit të mallit.**

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat respektivisht të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së **furnizimeve dhe / ose shërbimeve** të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

14.2 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

(c) Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);

(d) Dhe dokumente tjera të cilat vlerësohen të nevojshme të jenë pjesë e kësaj kontrate.

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

E hartuar në gjuhën **Shqipe** në katër origjinale, tri origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik:
"AWA" sh.p.k. – Prishtinë

Për Autoritetin Kontraktues – Komuna e Vushtrrisë

Emri: <i>per</i> Arjanit Rexhepi	Emri: Hyda Dallku
Pozita: Drejtor	Pozita: Drejtor i Drejtorisë për Prokurim Publik
Nënshkrimi: <i>[Signature]</i>	Nënshkrimi: <i>[Signature]</i>
Data: 01.07.2022	Data: 01.07.2022
Vula: <i>SHPK</i>	Vula:



KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: VU644-22-5562-1-3-6/C477

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë : gjuha në përdorim zyrtarë.
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Data e Fillimit të fillimit të Shërbimeve është : menjëherë pas nënshkrimit të kontratës, në bashkëpunim me menaxherin e kontratës të Autoritetit Kontraktues, sipas Porosive të bëra prej tij. Data e Përfundimit është : jo më gjatë se 15 ditë nga data e dërgimit të Porosisë për furnizim. Vendi i kryerjes së shërbimeve është : Furnizimet do të dorëzohen / pranohen në zyrën e kryetarit ose në vendin që do të saktësohet nga Menaxheri i Kontratës i A.K.
Siguria e ekzekutimit	14.1	Menaxheri i Kontratës është : do të emërohet me vendim të veçantë nga ZKA i Autoritetit Kontraktues. Norma e dëmeve të likuiduara : për shërbime të papërfunduara është ; 0,25 % në ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontratën është : deri në 10 % të çmimit final të kontratës.
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimit	15.1	Shume e Sigurisë së Ekzekutimit është : 10 % (Dhjetë përqindë) nga vlera e përgjithshme e kontratës. Dokumenti – Polis e sigurimit apo dokument bankar i lëshuar nga ndonjë Bank apo kompani e sigurimeve të licensuar nga Baka Qendrore e Kosovës me afat validiteti për periudhen e kohëzgjatjes kohore prej 45 ditësh nga data e nënshkrimit të kontratës.
Kualiteti i Kontrollit	17.1	Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në vijim: Të gjitha furnizimet e porositura do të konfirmohen se janë përfunduar në bazë të porosisë, nga Menaxheri i Kontratës i Autoritetit Kontraktues. Inspektimi i cilësisë dhe sasisë së ekzekutimit të furnizimeve do të bëhet nga Menaxheri i Kontratës i Autoritetit Kontraktues. Asnjë pranim i furnizimeve nuk do të konsiderohet valid dhe i pranuar, deri sa nuk konfirmohet me raport cilësia dhe sasi, nga Menaxheri i Kontratës i A.K.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatës Themelore në Prishtinë, - Departamenti për Çështje Ekonomike.

Pjesë përbërëse e policës: 37771

Për: **KOMUNA E VUSHTRISË**
(në vazhdim "Autoriteti Kontraktues")

Në emër të: **AWA SH.P.K., Rruga Ilaz Kodra, Dardani,**
(në vazhdim "tenderuesi")

VËREJTJE: NR I BRENDSHËM: VU644-22-046-136

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **BLERJA E APARATIT FOTOGRAFIK PROFESIONALE PER ZYREN E KRYETARIT**

Numri i prokurimit: **VU644-22-5562-1-3-6**

SIGURIA E KONTRATËS

Garancion me kërkesë të parë

DERISA operatori ekonomik i lartcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar Dosjes së Tenderit , me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues;

DHE NGASE operatori ekonomik dëshiron të depozitojë sigurinë në shumën e saktësuar në Dosjen e tenderit;

DHE NGASE ne jemi pajtuar t'i japim operatorit ekonomik këtë siguri:

ANDAJ NE të poshtë nënshkruarit, me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një total prej: **318.00 EURO (TREQIND E TETEMBEDHJETE EURO)** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mos pëmbushja e njërit nga kushtet në vijim:

(a) Autoriteti kontraktues ka konstatuar në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substancionale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë; dhe

(b) Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe /ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej: **318.00 EURO** siç është lartcekur, do të bëhet pa asnjë kundërshtim as ankesë, sa më shpejtë që është e mundur pas regjistrimit të kërkesës suaj me konfirmimin "e pranimit".

Kjo siguri vlen prej **01-07-2022 00:00:00** deri **15-08-2022 23:59:59**

Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit:

SCARDIAN Sigurime
Rr. Perandori Justinian Nr.3
10000 Prishtinë
Kosovë
2022-06-30 10:53:55





SCARDIAN

SIGURIME

0037771

NUMRI I POLICES

37771

SIGURUESI

K.S. SCARDIAN J.S.C

Adresa:

Rr. Perandori Justinian 3, 10000 Pristine,
Kosovo

AGJENTI

SCARDIAN HQ

Adresa:

Rr. Perandori Justinjan Nr. 69

I SIGURUARI

AWA SH.P.K.

Adresa:

Rruga Ilaz Kodra, Dardani,

NUMRI I BIZNESIT

811345976

NUMRI FISKAL

811345976

QËLLIMI I SIGURIMIT

Garanci e Kontratës

PËRFITUESI

KOMUNA E VUSHTRRISË

TITULLI I KONTRATËS

BLERJA E APARATIT FOTOGRAFIK
PROFESIONALE PER ZYREN E
KRYETARIT

NUMRI I IDENTIFIKIMIT-PROKURIMIT

VU644-22-5562-1-3-6

TERRITORI I MBULIMIT

Republika e Kosovës

PERIUDHA E SIGURIMIT

45 ditë

SHUMA E SIGURUAR

318.00 EURO

Nga:

01-07-2022 00:00:00

Deri:

15-08-2022 23:59:59

PRIMI I SIGURIMIT

20.00

TVSH 18 %

3.60

PRIMI +TVSH 18%

23.60

DATA E LËSHIMIT

2022-06-30 10:53:55

VËREJTJE: NR I BRENDSHËM:VU644-22-046-136

Polica e sigurimit të Garancive është krijuar në bazë të Ligjit Mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve Nr.04/L-077, të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me datë 10.05.2012, gjithashtu sipas Rregullave dhe Rregulloreve të Aprovuara nga Banka Qendore e Republikës së Kosovës.Pjesë përbërëse e kësaj police janë Kushtet e përgjithshme, pyetësoni i plotësuar dhe të nënshkruar dhe çfarëdo dokumenti tjetër i bashkangjitur me me policën e sigurimit.

Kjo policë sigurimi vërteton lidhjen e kontratës, dhe lëshohet nga Siguruesi në bazë të deklarimeve dhe kërkesave të bëra nga i Siguruarit/përfaqësuesi i të siguruarit, i cili është përgjegjës lidhur me saktësinë dhe vërtetësinë e deklarimeve të bëra prej tij.

Unë i Siguruarit/ përfaqësuesi i të siguruarit, deklaroj se i kam lexuar me vëmendje dhe i kam kuptuar kushtet e kontratës së sigurimit, deklaroj se pajtohem me to, si dhe me të dhënat dhe përcaktimet e kësaj police sigurimi, dhe po nënshkruaj konform vullnetit tim të lirë, e të plotë.

I SIGURUARI

(emri, mbiemri, nënshkrimi)

SCARDIAN



(emri, mbiemri, nënshkrimi)

Shënim: Te përshkrimi i çmimeve duhet plotësuar vetëm kolonat F dhe G
 Në kolonën F ju duhet të plotësoni duke shkruar normën e TVSH-së, vetëm si numër 0, 8, apo 18, e jo në formatin 0%, 8% apo 18%,
 Ndërsa në kolonën G, duhet ta plotësoni me çmimin për njësi me TVSH, po ashtu çmimin duhet ta shkruani me dy decimale pas presëjes
 dhejete

Nr.	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi për njësi pa TVSH	Norma e TVSH-së në %	Çmimi për njësi (me TVSh)-€	Totali (Pa TVSH)	Totali (me TVSH)	Totali (me TVSH)-€	Vendi i origjines së pajisjeve
1	Aparat profesional për fotografim	Copë	1.00	2,694.92	18.00	3,180.00	2,694.92	485.08	3,180.00	CHINA
TOTALI I PËRGJITHSHEM ME TVSH:							2,694.92	485.08	3,180.00	

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
EMRI I OE:	AWA SH.P.K.
EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TË OE:	Arjanit Rexhepi
NËNSHKRIMI:	
DATA:	17.06.2022
VULA:	